



# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- \* Aktivitetet tjera

Mars 2019

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### **E Drejta e pronësisë, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe të drejtat tjera sendore sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës**

Më 1 dhe 6 mars 2019 Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e USAID-it - "Programi i të Drejtave Pronësore – Property Rihgts Programe" organizoj dy trajnime, një për regjionin e Prizrenit, Gjakovës dhe Pejës dhe tjetrën për regjionin e Prishtinës me temë: "E Drejta e pronësisë, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe të drejtat tjera sendore sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës".

Me rastin e këtyre trajnimeve u trajtua Ligji për marrëdhëniet themelore pronësoro-juridike, fitimi dhe mënyrat e fitimit të pronësisë. Në vazhdim janë trajtuar edhe mbrojtja dhe pushimi i të drejtës së pronësisë, posedimi dhe llojet e tij, servitutet – fitimi, llojet, mbrojtja dhe pushimi i tyre.

Gjithashtu u ofruan njohuri themelore mbi praktikën gjyqësore të gjykatave kompetente lidhur me vendosjen e kontesteve pronësoro juridike sipas LMTHPJ dhe LPDTS, duke u thelluar në konceptet kryesore të dala nga kjo praktikë.

Në vazhdim gjatë këtyre trajnimeve u potencua se LPDTS kujdes të veçant i kushton rregullimit të së drejtës dhe të mënyrave të fitimit të pronësisë duke potencuar dy lloje të fitimit të

pronësisë: fitimin original dhe derivativ të pronësisë.

Derisa fitimi originer paraqet fitimin të cilin fituesi këtë të drejtë nuk e nxjerrë nga e drejta e mëparshme, por e fiton në mënyrë burimore, në bazë të fakteve juridike (sipas vetë ligjit, dhe në bazë të vendimit të organit shtetëror), ndërkaq, mënyrën derivative e karakterizon fakti se fituesi të drejtën e vet e nxjerrë nga e drejta e paraardhësit të tij (në bazë të punës juridike dhe me trashëgim).

Gjatë këtyre trajnimeve u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga ekspertët, përmes materialit të ofruar, analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e drejtë dispozitave ligjore në praktikë nga gjykatat kompetente si dhe përmes shpjegimeve të dispozitave ligjore mbi mënyrat e fitimit dhe mbrojtjes së pronësisë, të posedimit, mbajtjes, përkatësisht parashkrimit, të servitutit sipas LPDTS-së.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarët e gjykatave themelore të regjionit të Prizrenit, Gjakovës, Pejës dhe të Prishtinës

## Prishja e rendit dhe e qetësisë publike

Më 5 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temën “Prishja e rendit dhe e qetësisë publike”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve nga lëmia e rendit dhe qetësisë publike, veçanërisht me atë se si të dallojnë vendin publik nga ai jo publik duke e identifikuar veprimin inkriminues, si të përkufizojnë veprimin e sjelljes arrogante të sulmit verbal dhe mospërfilljen e urdhrave të ligjshëm, në mënyrë që t'i aplikojnë drejtë dispozitat sipas Ligjit për Rendin dhe Qetësinë Publike.

Trajnimi u fokusua në elaborimin e hollësishëm të çështjeve që kanë të bëjnë me dilemat që paraqiten në praktikë lidhur me: kundërvajtjet

kundër rendit dhe qetësisë publike, sjellja arrogante dhe sulmi verbal, mosveprimi sipas urdhrat të personit të autorizuar zyrtar sipas LRQP-së, mosveprimi sipas urdhrat të personit të autorizuar zyrtar në lëminë e komunikacionit rrugor, si dhe ndëshkimet për kryerësit e kundërvajtjeve - prishje e rendit dhe qetësisë publike.

Pjesëmarrësve në këtë trajnim përmes diskutimeve interaktive dhe shembujve praktik, iu ofruan alternativa të ndryshme për paqartësitë dhe vështirësitë e hasura gjatë punës së tyre në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor - divizioni për kundërvajtje, nga regjione të ndryshme të Kosovës.



## Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore

Më 7 mars 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Procedura penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore”.



Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të procedurave specifike tek rastet ku përfshihen kryerës të veprave penale me çrregullime mendore si dhe në kuptimin e kushteve lidhur me aftësinë e këtyre personave

për t’iu nënshtruar gjykimit.

Gjatë këtij sesiioni trajnimi u trajtua korniza ligjore vendore e cila rregullon këtë sferë, kushtet për shqiptimin e masave për trajtim të detyrueshëm, në veçanti u diskutua trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri.

Po ashtu, u shtjellua edhe zbatimi i ekzaminimit psikiatrik nga eksperti, qëllimi i këtij ekzaminimi dhe fazat e dhënies së urdhrit për ekzaminim psikiatrik me ç’ rast u potencua niveli jo i kënaqshëm i ekspertizave të përgatitura nga ekspertët.

Vëmendje iu kushtua edhe paraburgimit dhe kushtet e veçanta që duhet plotësuar për të përcaktuar paraburgimin ndaj personave me çrregullime mendore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Programi i Hetimeve Financiare– Trajnimi 1

Më 12-15 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNODC-in, ka realizuar trajnimin me temë “Programi i Hetimeve Financiare– Trajnimi 1”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive rreth bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më të suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të rastet e pastrimit të parave dhe veprave penale që ndërliken me to.

Ky trajnim trajtoj hetimet financiare mjetet dhe teknikat për analizën e të dhënave të shumta, detyrat dhe mjetet e përpunimit të të dhënave që kanë të bëjnë me burimet e informacionit. Po ashtu mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e

të dhënave financiare me qëllim që ato të dhëna financiare të kualifikohen si prova.

Vëmendje i’u kushtua paraprakisht hetimit të skemave në shkallë të gjerë të pastrimit të parave, krimeve tatimore dhe doganore duke përfshirë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar që në praktikë është mëse i nevojshëm për t’i hetuar dhe gjykuar këto vepra penale të cilat përbëjnë rrezik për zhvillimin ekonomik të një vendi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, bashkëpunëtorë profesional nga gjykata dhe prokuroria, zyrtarë nga NJIF, policë hetues nga Policia e Kosovës dhe zyrtarë ligjor nga të gjitha regjionet e Kosovës.

## Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj

Më 14 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së organizoj trajnimin me temë: “Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve dhe pjesëtimi i saj”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve, dhe pjesëtimin e saj.

Në pjesën e parë u trajtua pasuria e përbashkët dhe e veçantë e bashkëshortëve, pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve dhe pasuria e krijuar gjatë bashkësisë faktike (jashtëmartesore). Në pjesën e dytë u trajtuan vërtetimi i kontributit të bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe administrimi i pasurisë së përbashkët.

Në trajnim u theksua se bashkëshortët, përveç marrëdhënieve personale, gjatë jetës bashkëshortore, krijojnë edhe marrëdhënie pasurore, me ç’ rast krijojnë vlera pasurore, të cilat sipas Ligjit për Familjen i Kosovës, emërtohet si pasuri e përbashkët e bashkëshortëve. Bashkëshortët, në martesë janë të barabartë në të gjitha marrëdhëniet personale dhe pasurore, e cila garantohet me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)”, me Protokollin 7 të kësaj Konvente, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Familjen i Kosovës.

Në vazhdim u theksua se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve ka regjim të veçantë juridik, por këto norma nuk janë të karakterit detyrues sepse bashkëshortët mundën që me kontratë t’i rregullojnë marrëdhëniet e tyre pasurore. LFK ka përcaktuar se pasuria e përbashkët e bashkëshortëve mund të krijohet gjatë kohës së martesës dhe jetës së përbashkët të bashkëshortëve, me punë, si dhe format tjera të kontributit si: ndihmën e njërit prej bashkëshortëve të ofruar bashkëshortit tjetër, kujdesin për fëmijët, udhëheqjen e punëve të

shtëpisë, përkujdesjen dhe mirëmbajtjen e pasurisë si dhe çfarëdo forme tjetër të punës dhe të bashkëpunimit lidhur me administrimin, mirëmbajtjen dhe shtimin e pasurisë së përbashkët.

Gjithashtu u veqta konkludimi se ndarja e pasurisë së përbashkët mund të kërkohet gjatë martesës dhe pas pushimit saj. Të drejtë që të kërkojnë pjesëtimin e pasurisë së përbashkët kanë bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur të vdekur si dhe kreditori i njërit prej bashkëshortëve nëse kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet nga pasuria e veçantë bashkëshortit-debitor.

Një ashtu u konkludua se kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët konsiderohet se është i barasvlershëm. Bashkëshortët konsiderohen pronar të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse nuk janë marr vesh ndryshe. Por në rast kontesti ndarja e pasurisë së përbashkët bëhet me vendim gjyqësor me ç’ rast do të duhej që barra e provës t’i bie bashkëshortit-es i cili pretendon se ka kontribut më të madh në krijimin e pasurisë së përbashkët. Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin që përmes analizës së rasteve gjyqësore nga vendi dhe rajoni të zbërthejnë edhe më tutje dispozitat ligjore në kontestet e tilla gjyqësore.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore dhe bashkëpunëtorët profesional.





## **E drejta e mbrojtjes së pronës - Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore**

Më 18 mars 2019 Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “E drejta e mbrojtjes së pronës - Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ)”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me të drejtën e respektimit të pronës dhe mbrojtjes së saj konform standardeve që përmban KEDNJ dhe praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në Strasburg.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan nocionet themelore që përmban Neni 1 i Protokollit Nr.1 i KEDNJ, roli i së drejtës për respektimin e pasurisë së individit dhe mundësia e privimit nga kjo e drejtë për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuar nga ligji, si dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Po ashtu u trajtuan kushtet për ndërhyrjen në të drejtën e pronës për arsye të interesit publik dhe standardet dhe kriteret për kompensim për privimet nga prona në kontekst të neni 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ.

Trajnimi u përqendrua në shpjegimin e ndërhyrjes së domosdoshme në një shoqëri demokratike nga ana e autoriteteve kombëtare konform KEDNJ. Fokusi ishte edhe në shpjegimin e nocioneve dhe kategorive që përmban neni 1. i Protokollit 1, si dhe mënyra e interpretimit që bën GJEDNJ. Zbërthimi i të drejtave që përmbahen në këtë nenë të këtij Protokollit është i domosdoshëm për të kuptuar nocionet dhe mënyrën e interpretimit që bën GJEDNJ.

Në vazhdim u potencua se Kushtetuta e

Republikës së Kosovës shprehimisht e garanton të drejtën e pronësisë (neni 46) e kështu pacenueshmëria e së drejtës së pronës është pjesë përbërëse e vlerave të rendit kushtetues-juridik të Republikës së Kosovës dhe njëri nga parimet themelore për interpretimin e Kushtetutës. Edhe Ligji i Pronësisë dhe të Drejtave Tjera Sendore - nr 03/L-154 në nenin 1 përcakton krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen si dhe shuarjen e drejtave sendore.

Gjithashtu u potencua se neni 1. i Protokollit nr. 1. i Konventës mbron çdo të drejtë së cilës GJEDNJ i njeh natyrën pasurore në kuptim të vetë Konventës. Kjo është arsyeja pse thuhet se termi "pronësi" në kuptimin e konventës është autonom, që GJEDNJ me vendimet e saja interpreton se çka krejt konsiderohet pasuri, dhe që në kuptimin e nenit 1. Protokollit nr. 1. të Konventës pronën e mbron nga format e ndryshme të ndërhyrjes në këtë të drejtë, qoftë nëse ka të bëjë me ndërhyrjen që ka për pasojë veprime të autoritetit ekzekutiv ose administrativ të një shteti anëtar, qoftë ajo ndërhyrje që rrjedhë nga vetë ligjet pavarësisht nëse kjo është rezultat i ligjeve ose vendimeve gjyqësore, pavarësisht nga ajo se a bëhet fjalë për kontest juridiko-publik ose juridiko-privat.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin që përmes analizës së rasteve gjyqësore të GJEDNJ dhe rasteve tjera hipotetike të zbërthejnë legjislacionin që rregullon këtë materie.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës.

## Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftë kundër Korrupsionit Sesi I

Më 19-20 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme organizoi sesionin e parë të trajnimit me temë “Program i Specializuar Trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër korrupsionit”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë që të kuptojnë natyrën dhe format e korrupsionit si dhe veprat penale që janë të ndërlidhura me korrupsion.

Ky sesion trajnimi trajtoj veprat penale korruptive, kuptimin e korrupsionit sipas legjislacionit penal në fuqi, pasojat e korrupsionit si dhe format e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional të institucioneve të mandatuara për luftën kundër korrupsionit.

Gjithashtu gjatë trajnimit u elaboruan instrumentet vendore dhe ndërkombëtare në luftë kundër korrupsionit, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës korruptive si dhe masat për parandalimin dhe ekspozimin ndaj korrupsionit zyrtarë.

Po ashtu, me theks të veçantë është komentuar ligji tjetër i rëndësishëm nga pakoja anti-korrupsion, Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i cili paraqet një hap serioz drejt zbulimit të korrupsionit.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor të regjioneve të ndryshme të Kosovës.





## E DREJTA NË PRONË

### Pronësia e Përbashkët, Bashkëpronësia dhe Pasuria e Përbashkët

Më 20 mars 2019 në Gjilan si dhe me 21 mars 2019 në Mitrovicë, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme me përkrahjen e USAID-it - "Programi i të Drejtave Pronësore – Property Rihgts Programe" organizoj trajnimin me temë: "E Drejta në pronë: Pronësia e Përbashkët, Bashkëpronësia dhe Pasuria e Përbashkët".



Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve mbi bashkëpronësinë dhe pronësinë e përbashkët në Kosovë dhe trendët bashkëkohore si dhe zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi në vendosjen e kontesteve pronësoro juridike.

Me rastin e këtyre trajnimeve u zbërthye se çka përbën pasuri e përbashkët e bashkëshortëve, natyra juridike e saj dhe çka është pasuria e veçantë e bashkëshortëve, çka përfshin kontributi i bashkëshortëve në krijimin e pasurisë së përbashkët dhe si të vendoset drejtë dhe në mënyrë ligjore në kontestet në mes të bashkëshortëve kur kanë mosmarrëveshje për pasurinë e përbashkët si dhe disa probleme aktuale në praktikën gjyqësore kosovare.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar bashkëpronësisë, të drejtat e bashkëpronarit, administrimi i bashkëpronësisë dhe shuarja e bashkëpronësisë sipas Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS) . Në këtë pjesë është trajtuar edhe pronësia e përbashkët sipas këtij ligji si dhe pasuria e përbashkët sipas

Ligjit për Familjen i Kosovës (LFK-së) duke vënë në pah karakteristikat themelore dhe dallimet në raport me bashkëpronësinë, pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, sendet të cilat e përbëjnë pasurinë e përbashkët dhe pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës.

Në vazhdim gjatë këtyre trajnimeve është trajtuar: Pasuria e fituar në bazë të kontratës aleatore, paraja, sendet e blera me kredi, dhuratat që u jepen bashkëshortëve, përgjegjësia për borxhet, administrimi dhe disponimi me pasurinë e përbashkët dhe ndarja e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve.

Gjatë këtyre trajnimeve përmes rasteve praktike u mundësua identifikimi dhe dallimi i lehtë i formave të të drejtave të pronësisë dhe vendosja e rasteve lidhur me to, e veçmas përcaktimi i të drejtave të pronarëve të përbashkët duke përfshirë edhe të drejtën e pjesëtimit të pronësisë së përbashkët dhe mënyrën e pjesëtimit. Po ashtu u shpjegua zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore në rastet e vërtetimit të kontributeve të bashkëshortëve te pronësia e përbashkët e bashkëshortëve si njëri ndër problemet e mëdha në praktikën gjyqësore në Republikën e Kosovës.



Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Themelore të Gjilanit, Ferizajt, si dhe Mitrovicës.

## Vendimmarrja dhe qasja në drejtësinë mjedisore - standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi

Më 22 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme organizoj trajnimin me temë: “Vendimmarrja dhe qasja në drejtësinë mjedisore - standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni në fuqi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me drejtësinë mjedisore.

Në pjesën e parë të këtij trajnimi u trajtuan nocionet themelore që përmban Konventa e Aarhusit dhe legjislacioni nacional në fuqi, mënyrat e qasjes në informacione mjedisore dhe roli i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe të drejtat për qasje në informacionet mjedisore. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan roli dhe rëndësia e dispozitave mbi të drejtën për t’ju drejtuar gjykatës dhe përgjegjësia penale në fushën e mjedisit.

Trajnimi u përqendrua në trajtimin e problemeve dhe në zbatimin e standardeve ndërkombëtare dhe legjislacionit në fuqi në këtë lëmi në Republikën e Kosovës. Pastaj u shpjegua si mbrohen të drejtat e individëve për qasje në informacione mjedisore dhe pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes dhe si mund të zbatohet Konventa e Aarhusit në mënyrë të drejtpërdrejt si dhe përgjegjësia penale për ndotjen e mjedisit. Në vazhdim u potencua se Republika e Kosovës nuk është palë e Konventës së Aarhusit dhe nga të dhënat e siguruar rezultoi se zbatimi gjyqësor i kësaj Konvente në trajtimin e kontesteve administrative dhe civile është ende i mangët. Rrjedhimisht, gjyqtarët por edhe prokurorët u konkludua se kanë nevojë të

konsiderueshme që të avancojnë njohuritë e tyre rreth zbatimit të kësaj Konvente.

Më tej gjatë këtij trajnimi u elaboruan tre shtyllat themelore të cilat i përmban Konventa e Aarhusit si: 1. E drejta e publikut për të pasur e për të kërkuar informacion mjedisor; 2. E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit; 3. E drejta e publikut për t’u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit. Konventa e UNECE (KEE-OKB - Komisioni Ekonomik për Evropën i OKB-së) lidhur me të drejtën në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi në çështje mjedisore vendos një sërë të drejtash për publikun dhe detyrime për autoritetet shtetërore për të fuqizuar demokracinë mjedisore.

Në vazhdim u potencua se Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht e parasheh përgjegjësinë për mjedisin jetësor e cila më tej është e specifikuar edhe në Ligjin për Mjedisin si dhe aktet tjera ligjore duke ju referuar parimeve të Konventës Aarhusit për qasje në informata dhe për të drejtën për të kërkuar mbrojtje gjyqësore për mjedisin jetësor.

Pjesëmarrësit gjatë trajnimit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore nacionale dhe në nivel ndërkombëtar të zbërthejnë legjislacionin në fuqi që e rregullon këtë fushë. Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët, prokurorët si dhe bashkëpunëtorët profesional nga të gjitha nivelet në Republikën e Kosovës.

## Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës në procedurë penale

Më 25 mars 2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë: “Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës në procedurë penale”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale për udhëheqjen e shqyrtimit gjyqësor dhe veçanërisht në zbatimin e drejtë në radhën e marrjes në pyetje të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve si dhe marrjes së provës.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan çështjet si në vijim: shqyrtimi gjyqësor, provat në procedurën penale dhe ligjshmëria e provave, deklarata e të pandehurit si provë, provat e pranueshme, deklarata e dëshmitarit si dhe provat e pa pranueshme. Vëmendje të veçantë i është kushtuar marrjes në pyetje të palëve procedurale duke vënë në pah rëndësinë dhe vlerën provuese që kanë provat për vërtetimin e

drejtë dhe në mënyrë të plotë të gjendjes faktike në procedurë penale gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përveç procedurës së shqyrtimit kryesor është trajtuar edhe faza përgatitore për mbajtjen dhe parakushtet e mbajtjes së shqyrtimit kryesor. Më tej është trajtuar edhe radha dhe mënyra e nxjerrës së provave si dhe marrjes në pyetje të palëve procedurale me theks të veçantë kush duhet i pari të parashtrij pyetje nëpërmjet mënyrës së drejtpërdrejtë dhe kush mund dhe duhet të parashtrij pyetjet e tërthorta dhe në fund edhe provat në procedurën penale dhe ligjshmëria e provave me qëllim që të dallojnë provat e pranueshme dhe të papranueshme në procedurë gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëminë civile

Më 27 mars 2019, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëminë civile”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në lëminë civile.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: Juridiksioni dhe procedura sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës; Konventa e Lluganos; Konferenca e Hagës për të Drejtën Ndërkombëtare Private dhe konventat e kësaj Konference, Konventa e Brukselit mbi Jurisdikcionin dhe Zbatimin e Vendimeve në çështjet Civile dhe Tregtare e njohur si - Rregullorja Brukseli I; Urdhri Evropian për Përmbarrim (EEO); dhe Rregullorja mbi dorëzimin e dokumenteve nr.1393/2007.

Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan: Rregullorja për bashkëpunim ndërmjet gjykatave të shteteve anëtare për marrjen e provave në çështjet civile dhe tregtare; Instrumentet e tjera ndërkombëtare - Konventa e Minskut; Traktati i Kievit dhe Traktati i Moskës.

Në trajnim u theksua se bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet civile është një prej fushave më komplekse e karakterizuar me vështirësi në përcaktimin dhe aplikimin e ligjit të huaj, përfshirë këtu edhe një numër të çështjeve procedurale, siç janë çështjet e shërbimeve të dokumenteve ndërkufitare, ndihma juridike ndërkombëtare, njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore, etj.

Në trajnim u konkludua se Udhëzimi Administrativ për Procedurën e Ndhmës Juridike Ndërkombëtare në Çështjet Penale dhe Civile nr.2009/1-09, i miratuar nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës, ofron zgjidhje tejet sipërfaqësore për çështjet e

bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në lëminë civile. Deri më tani në Kosovë ka munguar baza ligjore, përkatësisht ende nuk është nxjerr ligj i veçantë i cili do të rregullonte fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, apo të drejtën ndërkombëtare private.

Gjithashtu u veqta konkludimi se organet kompetente shtetërore, duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për miratimin e një ligji të veçantë i cili do ta rregullonte fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, siç edhe është rregulluar kjo për lëminë penale.

Po ashtu u konkludua se nga ana e organeve shtetërore të Republikës së Kosovës, duhet të bëhet përpjekje maksimale për aderimin e saj në konventat dhe aktet apo instrumentet e tjera të së drejtës ndërkombëtare private të cilat e rregullojnë materien e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e: shpjegimit të pjesshëm teorik, diskutime interaktive, pyetje dhe përgjigje, analizë të rasteve gjyqësore nga vendi dhe rajoni, ku secili pjesëmarrës ishte aktiv gjatë kohës së zhvillimit të trajnimit.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

## **Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar dhe Krimi i Organizuar**

Më 28 –29 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së në bashkëpunim me GIZ-in, ka realizuar trajnimin me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar dhe Krimi i Organizuar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte funksionalizimi i pikave fokale me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më të suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë në rastet e krimit të organizuar.

Ky trajnim trajtoj masat hetuese moderne transkufitare, dëgjimi i dëshmitarëve duke përfshirë paraqitjen e kërkesave nga avokatët mbrojtës, dëgjimi me video konferencë, theksimi i rrezikimit të dëshmitarëve (dëshmitari anonim, të mbrojtur ). Po ashtu u trajtuan çështjet praktike që kanë të bëjnë me shkëmbimin e

ekspertizës, hetimet e fshehta në shtetet tjera - të mësuarit nga një rast konkret (kontrabandimi dhe shpërndarja e kundërligjshme e barnave me recetë) duke përfshirë edhe krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore - baza ligjore si pengesë, përvojat, sfidat, dhe praktikat më të mira, duke përfshir marrjen e dëshmive elektronike, dhe të dhënat e përmbajtjes.

Vëmendje i’u kushtua shqyrtimit paraprak të kërkesave të brendshme nga pikat fokale, shqyrtimi formal nga koordinatori, fushëveprimi i shqyrtimit formal/vendimet dhe propozimet e arsyeshme për grupet e rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë nga prokuroria speciale, zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë, policë hetues nga Policia e Kosovës dhe zyrtar ligjor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



## Të drejtat e pronësisë intelektuale – markat tregtare

Më 29 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së organizoj trajnimin me temë: “Të drejtat e pronësisë intelektuale – markat tregtare”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me rolin dhe rëndësinë e markave tregtare.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan roli dhe llojet e markave tregtare, të drejtat e titullarëve të markave tregtare si dhe mbrojtja juridike e markave tregtare.

Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan mënyrat e regjistrimit dhe humbja e të drejtës nga marka tregtare, procedurat ligjore dhe aplikimin e tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga markat tregtare.

Që në fillim të këtij trajnimi u potencua se markat tregtare janë kategori e rëndësishme nga të drejtat e pronësisë intelektuale që luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë e tregut, pasi që ndërmarrjet gjatë zhvillimit të afarizmit të tyre përdorin markat tregtare me qëllim të dallimit të produkteve dhe shërbimeve të tyre nga produktet dhe shërbimet e të tjerëve, si dhe për mbrojtjen e produkteve të tyre.

Në vazhdim u theksua se mbrojtja e markave tregtare garantohet me Ligjin për Markat Tregtare, Kodin Penal si dhe me masat tjera administrative duke përfshirë ato doganore, megjithatë në praktikën juridike paraqiten vështirësi të shumta në zbatimin e dispozitave

ligjore dhe ofrimin e mbrojtjes efektive. Numri i kontesteve në praktikën gjyqësore që rrjedhin nga markat tregtare është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes.

Duke rezimuar u konkludua se sipas standardeve ndërkombëtare të përcaktuara veçmas me Marrëveshjen TRIPS dhe direktivat e BE-së, shtetet duhet të sigurojnë mjete juridike të lehta, efektiv dhe jo të kushtueshme në mënyrë që bartësit të mos hezitojnë të e kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre pranë gjyqësorit.

Andaj, se një shtet për t'i përmbush obligimet ndërkombëtare në këtë lëmi, nuk është e mjaftueshme që vetëm në legjislacion të parasheh se bartësi i një marke tregtare ka këtë apo atë të drejtë: por mjete juridik në dispozicion duhet të jetë de facto efektiv dhe i zbatueshëm shpejtë.

Në këtë trajnim pjesëmarrësit përmes materialit dhe shpjegimeve të pjesshme teorike, diskutimeve, analizës së rasteve studimore, zbërthyen dhe sqaruan standardet ndërkombëtare dhe evropiane, dispozitat e Ligjit për markat tregtare dhe dispozitat tjera në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.





Gjithashtu në këtë trajnim përveç shpjegimit teorik pati edhe raste nga praktika gjyqësore si dhe u demonstruan mënyra të vendosjes meritorë në raste konkrete hipotetike. E tërë kjo u shoqërua me paraqitje edhe të rasteve nga praktika e GJDBE-së dhe praktika gjyqësore në vendin tonë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët nga departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës së Apelit dhe departamenti për çështje ekonomike i Gjykatës Themelore në Prishtinë si dhe gjyqtarët e prokurorët nga lëmia penale të cilët shqyrtojnë lëndë të natyrës së kriminit financiar veçmas markat tregtare.

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Fillimi zyrtar i gjyqtarëve të sapo emëruar (gjenerata e shtatë)

Më 11 mars 2019, Akademia e Drejtësisë, pas dekretimit të gjyqtarëve dhe kërkesës së KGJK-së, ka filluar zbatimin e Programit të Trajnimit Fillestar, duke realizuar në këtë formë takimin e parë me gjyqtarët e sapoemëruar.

Në fjalën hyrëse Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë, z. Valon Kurtaj, fillimisht i uroi gjyqtarët për emërimin e tyre, dhe i njoftoj ata me rolin dhe rëndësinë që ka trajnimi fillestar, për përgatitjen e tyre të mëtejme profesionale. Gjyqtarët e sapo emëruar u njoftuan rreth strukturës së trajnimit dhe mënyrës së realizimit e në veçanti u theksua rëndësia e bashkëpunimit të ndërsjellët gjatë këtij rrugëtimi një vjeçar.

Ndërsa, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Skender Çoçaj, shprehu mbështetjen e KGJK-së, si dhe i

inkurajoi gjyqtarët e sapo emëruar për një përkushtim dhe angazhim maksimal gjatë trajnimit fillestar, duke potencuar rëndësinë e këtij trajnimi, në përgatitjen adekuate të tyre që të ushtrjnë në mënyrë të drejtë dhe profesionale funksionin e gjyqtarit. Po ashtu z. Çoçaj ofroi mbështetje edhe për Akademinë e Drejtësisë, në drejtim të realizimit të suksesshëm të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar.

Gjyqtarët e sapoemëruar, janë pajisur me dokumente që hynë në kuadër të PTF-së, siç janë: Rregullorja për Programin e Trajnimit Fillestar, Programi i Trajnimit Fillestar si dhe Kalendarit trajnues për muajin mars 2019.

Trajnimin fillestar (2019/2020) do ta ndjekin 37 gjyqtarë të sapo emëruar ku prej tyre shtatë janë nga komunitetit serb.



## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VI)

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar.



Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar gjithsejtë 20 sesione trajnuese nga modulet: Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës.

Nga moduli: “Kodi i Procedurës Penale” janë realizuar tri (3) sesione trajnuese, ku nga nën modulet: Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, u diskutuan çështjet e arrestit shtëpiak, paraburgimit, diversionit, afatet kohore për caktimin e këtyre masave, shkaqet dhe rrethanat për caktimin e tyre, dallimin e masave dhe ndikimin e tyre në procedurë.

Nga nën moduli: Ekspertiza dhe Analizat janë realizuar katër (4) sesione trajnuese ku u trajtuan: kontrollimi i banesës dhe personit, mënyrat dhe kushtet e kontrollit, kompetencat e kontrollit, pranueshmëria e provave të marra gjatë kontrollit, bazat themelore për sekuestrim, sendet që mund të sekuestrohen, dallimi mes sekuestrimit dhe konfiskimit, baza juridike e marrjes së pasurisë të fituar me veprë penale, gjurmimi, ngrirja e aseteve, ndryshimet legislative mbi kompetencat e zgjeruara për konfiskim etj.

Gjatë muajit mars 2019, nga nën moduli: Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto çështje: inicimi i procedurës për negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, roli i prokurorit të shtetit në negociimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, pozita e palës së dëmtuar, rekomandimi i denimit, shqyrtimi gjyqësor sipas marrëveshjes për pranimin e fajësisë, dhe sistemet juridike të cilat e aplikojnë këtë institut.

Nga nën moduli: Masat e fshehta të hetimit dhe vëzhgimit janë realizuar katër (4) sesione trajnuese, ku gjyqtarët patën rastin të avancojnë njohurit lidhur me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit të urdhëruara nga prokurori i shtetit, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, pas fillimit të procedurës penale, dhe të drejtat e personave ndaj të cilëve zbatohet urdhri për masat e fshehta.

Gjithashtu nga nën moduli: Kontrolli dhe konfiskimi janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto çështje: mënyrat dhe kushtet e kontrollit, kompetenca për urdhër kontroll, kontrolli pa urdhër të gjykatës, nocioni i sekuestrimit të përkohshëm, bazat themelore për sekuestrim dhe procedura si provë, si mundësi dhe si dobi, mënyrat e sekuestrimit gjatë kontrollit, si dhe bazat juridike në legjislacionin tonë për sekuestrimin dhe konfiskimin.

Gjatë muajit mars, në kuadër të trajnimeve të organizuara nga Bashkimi Evropian, gjyqtarët e sapo emëruar kanë realizuar 2 sesione trajnuese me temë: Të drejtat e viktimave të krimit.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 10 ditë trajnimi praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur pesë (5) gjyqtarë të komunitetit serb.

## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII), ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar.

Më 11 Mars 2019, gjyqtarët e sapo emëruar filluan zyrtarisht trajnimin një (1) vjeçar në Akademinë e Drejtësisë. Sipas programit trajnues gjyqtarët e sapo emëruar do të ndjekin 6 module trajnuese si dhe trajnimin praktikë në gjykata nën mbikëqyrjen e mentorit (gjyqtar). Në kuadër të trajnimit teorik në periudhën raportuese janë realizuar gjithsejtë 12 sesione trajnuese nga moduli: E drejta civile, administrative dhe ekonomike.

Nga nën moduli: “E drejta Civile” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese, ku u shtjelluan temat si krijimi dhe mbarimi i punëve juridike, modifikimi i punëve juridike, posedimi dhe llojet e posedimit, të drejtat absolute dhe relative, përfaqësimi dhe përfaqësimi me

prokurë, punët juridike të njëanshme, të dyanshme, dhe punët juridike nule, veprimet e palejueshme-deliktet dhe pasurimi i pa bazë.

Nga nën moduli: Procedura Kontestimore – pjesa e parë janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të zgjerojnë njohurit lidhure me: parimet e procedurës kontestimore, shqyrtime të përgjithshme lidhur me kompetencën, përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit, palët në procedurën kontestimore, parashtresat dhe dërgimi i shkresave dhe seancat, si dhe afatet dhe kthimi në gjendjen e mëparshme.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 8 ditë trajnimi praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur (39) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.





## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit mars 2019, në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapoemëruar, janë zhvilluar aktivitete si në trajnimin teorik po ashtu edhe në trajnimin praktik.

Në këtë periudhë në trajnimin teorik janë realizuar gjithsejtë dy (2) sesione trajnuese nga modulet: “Kodi i Procedurës Penale” dhe “Rendi Juridik kombëtar dhe ndërkombëtar”

Nga nën moduli “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” është realizuar një (1) sesion trajnues, ku prokurorët kanë pasur mundësi të thellojnë njohurit e tyre rreth llojeve të masave për sigurimin e pranisë së të pandehurit, në veçanti për arrestin shtëpiak, paraburgimin, diversionin, afatet kohore për caktimin e këtyre masave, shkaqet dhe rrethanat për caktimin e tyre, dallimin e masave dhe ndikimin e tyre në procedurë etj.

Sipas programit trajnues prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar një (1) sesion trajnues nga nën moduli “E drejta Kushtetuese” me ç’rast është trajtuar historiku i së drejtës kushtetuese në Kosovë, burimet e të drejtës kushtetuese, raporti i burimeve të së drejtës kushtetuese në Kosovë dhe vendeve evropiane, krahasimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese

në Kosovë me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, reformimi i Gjykatës Kushtetuese në Kosovë, efekti juridik i vendimeve të dala nga ajo etj.

Gjithashtu në bashkëpunim me Ambasadën Franceze, prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar edhe një trajnim me temë: Trafikimi me qenie njerëzore dhe shpëlarja e parave.

Gjatë muajit mars prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar edhe 2 vizita në institucione jo gjyqësore: Administrata Tatimore e Kosovës dhe Komisionin e Ndërmjetësimit.

Gjithashtu gjatë muajit mars, më datë 18,19 dhe 20 Mars 2019, prokurorët e sapo emëruar iu kanë nënshtruar provimit përfundimtar pas përfundimit të trajnimit teorik në Akademinë e Drejtësisë.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (13) ditë trajnimi praktikë në prokurorit përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 21 prokuror të sapo emëruar, dy prej tyre janë të komunitetit serb.



## Administrata Tatimore e Kosovës

Më 07 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve Fillestare, organizoi për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII) trajnimin me fokus në “Administratën Tatimore të Kosovës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të prokurorëve të sapo emëruar lidhur me rolin, përgjegjësitë dhe punën praktike të Administratës Tatimore të Kosovës.

Fillimisht u pasqyrua veprimtaria e institucionit si dhe sfidat aktuale me të cilat ballafaqohet ATK, në drejtim të përmbushjes së mandatit të saj. Fokusi i këtij trajnimi qëndron tek legjislacioni i aplikueshëm tatimor në Kosovë,

normat dhe llojet e tatimeve, procedurat e aplikueshme në ATK, si dhe çështje tjera që ndërlidhen me punën praktike të prokurorëve dhe lëndët e kësaj natyre me të cilat do të ballafaqohen në praktikë.

Trajnimi ishte i karakterit interaktiv me ç ‘rast, prokurorët e sapoemëruar, bashkërisht me zyrtarët nga ATK-së, diskutuan për çështjet e interesit të përbashkët, me qëllim vendosjes së bazave të para të bashkëpunimit reciprok.

Përfitues të trajnimit ishin Prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII) 2018-2019.





## Procedura e Ndërmjetësimit

Më 25.03.2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimeve Filles-tare, organizoi për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII) trajnimin me temë



”Procedura e Ndërmjetësimit”.

Qëllimi i trajnimit ishte që pjesëmarrësit të njoftohen më shumë rreth historikut të procedurës së ndërmjetësimit në Kosovë, fushat në të cilat zbatohet, rëndësia e tij në procedurën penale, për dallim nga procedura civile etj.

Fillimisht u trajtua baza ligjore e procedurës së Ndërmjetësimit, e cila është e rregulluar me Ligjin për Ndërmjetësim në Kosovë.

Gjithashtu u trajtuan ndryshimet legjislative që ka pësuar ligji i ndërmjetësimit, zgjerimin e kompetencave të tij,

marrëveshjet para ndërmjetësuesve, personat të cilët kanë të drejtë që të jenë ndërmjetësues etj.

Si temë e diskutimit ishin edhe dallimet mes procedurës së ndërmjetësimit në fushën penale dhe civile, marrëveshja e ndërmjetësimit e arritur në gjykatë, si dhe efekti juridik i marrëveshjes së ndërmjetësimit. Po ashtu, diskutimet vazhduan edhe sa i përket numrit të personave të përfshirë në ndërmjetësim, procedura e marrjes së titullit ndërmjetësues, dhe kushtet që një marrëveshje duhet t'i plotësoj që të mund të zgjidhet përmes ndërmjetësimit.

Pjesëmarrësit u njoftuan më gjerësisht edhe për departamentet për profesionet e lira në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ku bën pjesë edhe ndërmjetësimi, gjithashtu u njoftuan edhe për odën e ndërmjetësuesve, llojet e ndërmjetësimit e në veçanti për ndërmjetësimin për të mitur, rolin e prokurorit të shtetit si dhe kujdesin që duhet të ketë kur një marrëveshje përfundon me ndërmjetësim.

Përfitues të trajnimit ishin: Prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VII), 2018-2019.



## Aktivitetet tjera

### Alimentacioni dhe besimi i fëmijës

Më 01.03.2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për profesionet e lira me kërkesën e Agjencisë për Ndhmë juridike Falas e mbështetur nga UNDP, organizoi trajnimin me temë : “Alimentacioni dhe besimi i fëmijës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me alimentacionin dhe besimin e fëmijës dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në kontestet martesore-familjare në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nga ana e zyrtarëve të ndihmës juridike falas.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan çështjet si parimet e përgjegjësisë së prindërve, parimet për

caktimin e alimentacionit, mbajtja financiare dhe ushqimi –Alimentacioni, besimi, ruajtja dhe kujdesi i fëmijëve si dhe kontakti, besimi i fëmijës njërit prind dhe caktimi i kontaktit për tjetrin si dhe besimi i fëmijës personit të tretë. Gjithashtu vëmendje të veçantë iu kushtua edhe shkurorezimit dhe ndikimi i tij në personalitetin e fëmijës duke theksuar zbatimin e standardeve dhe legjislacionit ndërkombëtar në këtë vështrim.

Pjesëmarrësit gjatë gjithë trajnimit patën rastin që përmes diskutimit të rasteve praktike të sqarojnë dilemat dhe vështirësitë që hasin në ofrimin e ndihmës juridike në këtë fushë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin zyrtarët nga Agjencia për Ndhmë Juridike Falas.



## Akademia e Drejtësisë organizon programin e praktikës për kandidatet e Shkollës së Magjistraturës së Francës (ENM)

Më 04-22 Mars 2019, Akademia e Drejtësisë në vazhdimësi të bashkëpunimit me Ambasadën Franceze në Kosovë dhe me Shkollën e Magjistraturës së Francës, edhe këtë vit priti dhe organizoi programin e praktikës për dy kandidatet e Shkollës së Magjistraturës.



Qëllimi i këtij programi ishte njoftimi i kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të Francës, me sistemin gjyqësor në Kosovë, veçanërisht në ndjekjen, hetimin dhe gjykimin e veprave penale, si dhe zbatimin e dënimeve, çështjet gjyqësore civile, si dhe sistemi i të trajnimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky program u realizua duke filluar me takimin pritesë në Akademinë e Drejtësisë, ku u diskutua agjenda e këtij programi dhe u vazhdua me vijim të një trajnimit për prokurorët e

sapoemëruar në Programin Fillestar në Akademi, si dhe me vizita në institucionet gjyqësore dhe jo gjyqësore, që ishin me interes për kandidatet.

Programi ka përmbajtur trajnimin praktik të realizuar në zyrat e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, dhe Gjykatës Themelore të Prishtinës - departamenti i përgjithshëm, krimeve të rënda dhe ai civil, me qëllim që të shihet drejt për drejtë aplikimi i ligjit, mënyra e mbajtjes së seancave gjyqësore, pra në përgjithësi funksionalizimi i sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë.

Fokus i kandidateve këtë herë ishte krahasimi i legjislacionit në fushën e Konfiskimit dhe Sekuestrimit, për çfarë u realizua takimi informues me Koordinatorin Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik. Po ashtu, takime mbajtën edhe me institucionet tjera si EULEX, Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe të ngjashme.

Programi i praktikës për kandidatet e ENM-së është përmbyll me një takim me Koordinatorin e Programit të AD-së, ku u shkëmbyen përshtypjet dhe rekomandimet lidhur me këtë program dhe bashkëpunimin në të ardhmen.





## Nënshkruhet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Fakultetit Juridik të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”

Prizren, 8 mars 2019, z. Valon Kurtaj - Drejtori Ekzekutiv dhe z. Faton Fetoshi U.D. Drejtori për Administratë dhe Financa në Akademinë e Drejtësisë zhvilluan një takim miqësor me përfaqësues të Universitetit të Prizrenit “Ukshin Hoti”.



Qëllimi i këtij takimi ishte nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit për mbajtjen e praktikës së studentëve të Fakultetit Juridik të këtij Universiteti në Akademinë e Drejtësisë.

Përfaqësuesit nga Rektorati dhe Dekani i Fakultetit Juridik z. Halim Bajraktari në Universitetin e Prizrenit, shprehën kënaqësinë e tyre për themelimin e këtij bashkëpunimi me Akademinë e Drejtësisë, duke e konsideruar si hap shumë të rëndësishëm për studentët, sepse ndërlihdja e njohurive teorike me ato praktike është e domosdoshme për ta.

Përgjatë takimit të dy palët u pajtuan të organizojnë aktivitete të përbashkëta profesionale me qëllim të shkëmbimit të praktikave në drejtëm të rritjes së cilësisë së programit të trajnimit praktik për studentët. Dhe gjithashtu u pajtuan që është e domosdoshme që të kenë projekte të përbashkëta kërkimore, shkencore dhe hulumtuese.



## Dhuna në Familje

Me 14.03.2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të UNDP-së ka realizuar trajnimin me temë: “Dhuna në familje”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të Ligjit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në rastet e tilla nga ana e zyrtarëve të ndihmës juridike falas.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan konceptet themelore të Ligjit për mbrojtjen nga dhuna në familje i cili kërkon pa diskriminim që ti ndihmojë personat e prekur nga Dhuna në familje si dhe çështjet tjera si: format e shfaqjes së dhunës në familje, urdhri për mbrojtje, kushtet për caktimin e urdhrit për mbrojtje si dhe masat për parandalimin e dhunës. Gjithashtu vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe prezencës së zyrtarit për mbrojtjen e viktimave gjatë deklaratës së parë të dhënë nga

viktima duke e ditur se ajo deklaratë është më reale dhe më e sinqertë e cila pasqyron në përpikëri përjetimet që ka pasur. Më tej janë dhënë sqarime për rolin e policisë, Zyrës për mbrojtjen e viktimave dhe Qendrës për punë sociale si dhe vetë Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në trajtimin e këtyre rasteve.

Në pjesën e pasdites u diskutua për procedurën gjyqësore, vendimet gjyqësore, ekzekutimin e urdhrit për mbrojtje dhe pasojat për shkelje të urdhrit për mbrojtje si dhe rastet dhe problemet praktike të zyrtarëve të ANJF në trajtimin e këtyre rasteve duke adresuar zgjidhjet në pajtim me dispozitat ligjore.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjionet. Pjesëmarrës në trajnim ishin edhe përfaqësues të OJQ-ve si CRPK, CLARD, NORMA si dhe Femrat Aktive të Gjakovës.



## Përpilimi i mjeteve juridike në procedurën kundërvajtëse

Me 15.03.2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas në mbështetje të UNDP-së ka realizuar trajnimin me temë: "Përpilimi i mjeteve juridike në procedurën kundërvajtëse".



Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave të Ligjit për Kundërvajtje dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në rastet e tilla nga ana e zyrtarëve të ndihmës juridike falas.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan konceptet themelore rreth përcaktimit të veprës kundërvajtëse me ligj si dhe çështjet tjera si: parimet që duhet të zbatohen, përgjegjësia kundërvajtëse (përgjegjshmëria dhe papërgjegjshmëria), mjetet juridike (të rregullta dhe të jashtëzakonshme), arsyet e paraqitjes së mjeteve juridike, si dhe shkeljet esenciale. Gjithashtu vëmendje të veçantë i është kushtuar

procedurës sipas ankesës duke e ditur se një numër i madh i ankesave në gjykatë vijnë të përpiluara nga zyrtarët e Ndhimës Juridike Falas. Lidhur me këtë janë ofruar këshilla se si duhet të veprohet në këtë procedurë si dhe janë ofruar praktikat më të mira të hartimit të shkresave.

Në pjesën e pasdites pjesëmarrësit patën rastin që përmes punës të ndarë në katër grupe të demonstrojnë shkathtësitë e përpilimit të ankesës për 4 situata të ndryshme hipotetike si në vijim: në përpilimin e ankesës për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave kundërvajtëse, për shkak të shkeljeve të ligjit material, për shkak të vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të lartësisë së shqiptimit të dënimit.

Me rastin e prezantimit të punës në grupe, pjesëmarrësit shpalosën përvojën e tyre duke shfrytëzuar njohuritë që morën gjatë pjesës së parë të trajnimit si dhe përvojat e tyre në këtë fushë duke përfunduar në mënyrë korrekte detyrat që u janë dhënë.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar edhe rasteve praktike të zyrtarëve të ANJF në trajtimin e rasteve në procedurën kundërvajtëse duke adresuar zgjidhjet në pajtim me dispozitat ligjore.





## Nënshkruhet Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 20 mars 2019, z. Valon Kurtaj – Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe z. Bahri Hyseni – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet të dy institucioneve.



Qëllimi i nënshkrimit të këtij memorandumi është mbështetja e avancimit profesional dhe lehtësimi i zhvillimit të programeve të trajnimit

për sistemin prokurorial.

Të dy palët u pajtuan që të bëjnë shkëmbimin e informatave për vlerësimin e nevojave trajnuese për prokurorët dhe stafin administrativ, të ketë bashkëpunim gjatë hartimit të programeve trajnuese, të bëhet shkëmbimi i informatave lidhur me pjesëmarrjen në trajnime të prokurorëve dhe stafit administrativ. Gjithashtu me anë të këtij memorandumi AD dhe KPK u pajtuan që përmes data bazave elektronike të shkëmbejnë të dhënat bazike të prokurorëve dhe stafit administrativ lidhur me pjesëmarrjen në trajnime dhe programeve tjera të Akademisë së Drejtësisë.

## Kompensimi i dëmit

Me 25.03.2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të UNDP-së ka realizuar trajnimin e radhës me temë: “Kompensimi i dëmit”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në rastet e kërkesave për kompensimin e dëmit.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan konceptet themelore të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve me fokus te shkaktimi i dëmit, shkaktimi i dëmit nga mjetet e rrezikshme, dëmi i shkaktuar nga veprimtaria e kundërligjshme, llojet e shpërblimit të dëmit, përgjegjësia juridike civile si dhe bazat e përgjegjësisë për dëmin material dhe jo material si dhe kriteret për caktimin e dëmit. Vëmendje të veçantë kishte studimi i çështjes nga ofruesit e ndihmës

juridike në rastet e tilla dhe përpilimi i kërkesës për kompensim të dëmit duke përfshirë elementet që duhet të përmbajë kërkesa për kompensim. Gjatë trajnimit u diskutuan rastet më të shpeshta nga praktika gjyqësore si dhe rastet nga praktika e ANJF përmes të cilave u dhanë sqarime të nevojshme për mënyrën se si duhet vepruar që të jenë të realizueshme kërkesat për kompensim të dëmit.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjionet e Kosovës. Pjesëmarrës në trajnim ishin edhe përfaqësues të OJQ-ve si CRPK, CLARD, NORMA si dhe Femrat Aktive të Gjakovës.



## Parimet bazë të pronësisë

Me 26.03.2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të UNDP-së ka realizuar trajnimin e radhës dhe të fundit nga cikli i trajnimeve sipas programit për zyrtarët e ndihmës juridike falas temë: “Parimet bazë të pronësisë”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat tjera Sendore dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në rastet për vërtetimin e pronësisë, posedimin dhe pengim posedimin.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan konceptet themelore të Ligjit për Pronësi dhe të Drejtat Sendore, me fokus te fitimi i pronësisë, mënyrat

e fitimit të pronësisë, vërtetimi i pronësisë, posedimi dhe pengim posedimi. Vëmendje të veçantë kishte studimi i çështjes nga ofruesit e ndihmës juridike në rastet e tilla dhe përpilimi i kërkesave që u referohen këtyre çështjeve.

Gjatë trajnimit u diskutuan rastet më të shpeshta nga praktika gjyqësore si dhe rastet nga praktika e ANJF përmes të cilave u dhanë sqarime të nevojshme për mënyrën se si duhet vepruar që të jenë të realizueshme paditë për fitimin e pronësisë, vërtetimin e pronësisë dhe pengim posedimin.

Në pjesën e pasdites pjesëmarrësit patën rastin që edhe përmes punës në grupe dhe detyrave të identifikojnë elementet që duhet të përmbajë padia në kontestet pronësoro juridike, veçanërisht për pengim posedimin.

Përfitues në këtë trajnim ishin zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjionet e Kosovës. Pjesëmarrës në trajnim ishin edhe përfaqësues të OJQ-ve si CRPK, CLARD, NORMA, Femrat Aktive të Gjakovës, Institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe Zyrtar të Zyrës për Mbrojtje të Viktimave .



## Shkëmbimi i Praktikave më të Mira në Luftën Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore

Me 27 mars 2019, Akademia Drejtësisë në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Kosovë ka organizuar një trajnim me temën “Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte shkëmbimi i përvojave rreth politikave për luftimin kundër trafikimit me qenie njerëzore duke u fokusuar në mjetet e bashkëpunimit teknik dhe gjyqësor si dhe rolin e shoqërive civile në kujdesin ndaj viktimave.

Në hapje të këtij trajnim ishte i pranishëm z. Dieder Chabert – Ambasador i Republikës së Francës në Kosovë si dhe z. Jean-Louis Falconi, Përfaqësues i Përhershëm i Francës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe

Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë.

Drejtori i Akademisë së Drejtësisë falënderoj Ambasadën Franceze në mbështetje që i ka ofruar Akademisë së Drejtësisë si dhe sistemit gjyqësor në përgjithësi. Gjithashtu Ambasadori francez z. Dieder Chabert shpалosi aktivitetet e Ambasadës Franceze në fushën e trafikimit me qenie njerëzore duke vlerësuar këtë bashkëpunim në drejtim të ndërtimit të strategjive kundër këtij fenomeni.

Gjatë këtij trajnimi znj. Caroline Charpentier, gjyqtare dhe Këshilltare Rajonale për Luftimin kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore në Evropën Jug – Lindore ka prezantuar instrumentet teknike dhe gjyqësore të bashkëpunimit rreth këtij fenomeni. Gjithashtu vëmendje të veçantë i është kushtuar strategjisë së hetimit penal, bashkëpunimit me autoritetet e zbatimit të ligjit dhe organizatave jo qeveritare, përparësitë dhe dobësitë në dosjet e trafikimit si dhe trendet aktuale në këtë fushë.

Përfituesit e këtij trajnimi janë prokurorët e sapo emëruar gjenerata e shtatë.





## Takimi i 6-të i Komitetit Drejtues të Projektit iPROCEEDS

Më 29 mars 2019, në kuadër të projektit iPROCEEDS, në Bukuresht të Rumanisë është mbajtur “Takimi i 6-të i Komitetit Drejtues të Projektit”.

Qëllimi i takimit ishte njoftimi i komitetit drejtues rreth zbatimit të projektit, në përcaktimin e strategjive të nevojshme për implementimin e projektit, si dhe përcaktimin e nevojave të autoriteteve kombëtare për mbështetje në të ardhmen në ngritjen e kapaciteteve.

Fillimisht në takim u prezantuan aktivitetet e realizuara gjatë periudhës korrik - dhjetor 2018, nga zyra e programit për kriminalitet kibernetik të Këshillit të Evropës. Më tej u diskutua legjislacioni për krimin kibernetik, krimet e koordinuara të krimit kibernetik, politikat dhe strategjitë e sigurisë së kibernetikës si dhe sistemet e raportimit publik.

Gjatë takimit u diskutua për forcimin e kapaciteteve të njësive të specializuara hetuese dhe bashkëpunimin ndërmjet agjencive midis

krimit kibernetik, hetuesve financiarë, prokurorëve, përfaqësuesve të NJIF-ve dhe ekspertëve të sigurisë në kibernetikë si dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve të drejtësisë penale dhe ofruesve të shërbimeve vendore dhe multinacionale. Me theks të veçantë u diskutua për Programet e trajnimit lidhur me krimin kibernetik të cilat organizohen për gjyqtarët dhe prokurorët, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe shkëmbimi i informacionit.

Sesioni i fundit iu kushtua planeve të ardhshme dhe nevojave të autoriteteve kombëtare. Me ç’rast patën mundësinë të marrin fjalën përfaqësuesit nga të gjitha regjionet pjesëmarrëse për ti prezantuar nevojat që kanë në lidhje me këtë fushë.

Në këtë takim nga Republika e Kosovës morën pjesë: Prokuror, zyrtar të lartë policor nga departamenti për krimin kibernetik si dhe U.D Udhëheqëse e Programit për Trajnime të Vazhdueshme nga Akademia e Drejtësisë.



**<https://ad.rks-gov.net>**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**